

1 E premte, 30 prill 2021

2 [Konferencë për ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk janë të pranishëm]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve, dhe  
7 mirë se keni ardhur të gjithë brenda dhe jashtë sallës.

8 Ju lutem sekretare, thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Është çështja  
10 KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe  
11 Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Dhe tani u lutem palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen,  
14 duke filluar me Prokurorinë.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëmëngjes. Matt Halling, prokuror,  
16 bashkë me Alex Whiting, Zëvendësprokuror; dhe Line Pedersen,  
17 menaxhere e çështjes.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.

19 Tani i drejtohem Mbrojtjes.

20 Z. Rees, ju lutem.

21 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar, unë quhem  
22 Jonathan Rees, jam -- përfaqësoj z. Gucati, për -- ndihmohem nga  
23 Huw Bowden.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

25 Ju lutem, z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Toby  
2 Cadman për z. Nasim Haradinaj. Bashkë me mua është dhe  
3 bashkëmbrojtësi dhe asistentja ligjore.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i kthehem -- i drejtohem  
5 Zyrës së Administratës.

6 Z. ROCHE: [Përkthim] Ralph Roche, kryetari i Departamentit të  
7 Shërbimeve Gjyqësore.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë jam Nicolas Guillou,  
9 Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

10 Më 23 prill [sipas përkthimit] parashikova konferencën e  
11 sotme për të parë ecurinë e çështjes dhe për të shkëmbyer -- për  
12 të siguruar shkëmbimin e mendimeve midis palëve për një përgatitje  
13 të shpejtë për gjyq.

14 Dua të diskutoj nxjerrjen e materialeve, qasjen e të  
15 akuzuarit në dokumente, marrëveshje për pika ligji dhe fakti,  
16 përkthimet, dhe statusin e hetimeve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes.

17 E falënderoj ZPS-në, Mbrojtjen dhe Zyrën e Administratës për  
18 parashtrimet me shkrim. Nuk ka nevojë që këtu t'i përsërisim këto  
19 parashtrime me hollësi, por i ftoj palët të përgjigjen për  
20 parashtrimet e njëri-tjetrit në mënyrë të përmbledhur sipas pikave  
21 të programit.

22 Si zakonisht, i kujtoj palët të japin njoftim paraprak nëse  
23 duan që të japin informacion konfidencial që të futemi në seancë  
24 private apo të mbyllur.

25 Dhe tani të kalojmë te pika e parë e programit, nxjerrja e

1 materialeve. Dua të dëgjoj nga palët për progresin e bërë lidhur  
2 me nxjerrjen e materialeve provuese.

3 Përpara se t'ju jap fjalën, dua të dëgjoj nga ju sa më  
4 poshtë:

5 Së pari konstatoj parashtrimin e ZPS-së që nuk ka pasur  
6 ndonjë progres lidhur me kërkesën që ka mbetur e palës së tretë.  
7 Gjithashtu konstatoj se ZPS-ja përfundoi nxjerrjen e të gjithë  
8 materialit në zotërim të saj sipas rregullës 102(1)(a), 102(1)(b,  
9 dhe 103, dhe se përpjekja e fundit për të nxjerrë materialet do të  
10 nxirren sipas afatit që kam dhënë unë në vendimin tim në bazë të  
11 rregullës 102(3).

12 Konstatoj më tej se ZPS-ja ka nxjerrë një dokument të  
13 mëtejshëm, duke përfshirë dhe një tabelë të bashkëngjitur, në  
14 përputhje me vendimin tim F171. Kam tre pika për të thënë.

15 Së pari, konstatoj se ky dokument përmban një listë të  
16 gabimeve të identifikuar nga ZPS-ja lidhur me një tabelë të  
17 mëparshme të nxjerrë sipas vendimit tim F141. Në lidhje me këtë,  
18 synoj të lëshoj një urdhër me gojë pasi -- sot pasi të kem dëgjuar  
19 nga palët.

20 Së dyti, konstatoj se dokumentet e lartpërmendur janë nxjerrë  
21 sipas rregullës 102(1)(b) pavarësisht nga fakti se informacioni që  
22 përbën subjektin e këtyre dokumenteve është vendosur se është --  
23 mund të nxirret sipas rregullës 102(3). Pra, e ftoj ZPS-në të  
24 shpjegojë nëse ajo synon që t'i paraqesë këto dokumente në gjyq.

25 Së treti, konstatoj se dokumenti i nxjerrë përpara -- më parë

1 me numër ERN 093492-093590, është shtuar në listën e provave të  
2 ZPS-në të parashtruara më 9 prill. Gjithashtu konstatoj se në një  
3 parashtrim të fundit ZPS-ja kërkon të shtojë një dokument të ri me  
4 numër ERN 095162-095239 tek ajo listë. Gjithashtu, dua që të  
5 nxjerr një urdhër me gojë sot pasi të kemi -- të kam -- të kem  
6 dëgjuar nga palët.

7 Konstatoj se të dy ekipet e Mbrojtjes nuk pajtohen me ZPS-së  
8 për plotësinë e procesit të nxjerrjes. Në veçanti, konstatoj se të  
9 dy ekipet e Mbrojtjes parashtrojnë se lista e konsoliduar në bazë  
10 të rregullës 102(3) është e paplotë dhe e paqartë -- apo e  
11 paqartë, dhe se çdo kërkesë në këtë drejtim -- duke përfshirë për  
12 material të parenditur në njoftimin e konsoliduar.

13 Gjithashtu konstatoj se Mbrojtja Haradinaj ngrenë çështjen e  
14 plotësisë së nxjerrjes në bazë të rregullit 103, duke pas parasysh  
15 numrin e individëve që ZPS-ja ka folur -- me të cilët ka folur  
16 ZPS-ja dhe informacionin e dhënë për këto deklaratë.

17 Konstatoj se Mbrojtja e Haradinajt mendon që ZPS-ja nuk ka  
18 kryer një hetim të njëmendtë dhe se prova të mëtejshme duhen të  
19 bëhen të njohura.

20 Gjithashtu konstatoj se Mbrojtja e Haradinajt deklaron se nuk  
21 është në gjendje të parashtojë kundërshtime, në qoftë se ka, për  
22 materialet provë të nxjerra në bazë të rregullës 102 në kohën që  
23 nxjerrja vazhdon akoma. Mbrojtja e Gucatit parashtron se do të  
24 paraqiste një kundërshtim të tillë ndaj materialit provë të  
25 nxjerrë, sikurse është identifikuar më 14 qershor '21 -- deri më

1 14 qershor.

2 Përpara se t'i jap fjalën palëve, u kujtoj të gjithëve se një  
3 kërkesë nga ZPS-ja lidhur me materialitetin e disa dokumenteve të  
4 kërkuara nga Mbrojtja është ende i pashqyrtuar. Pra, i ftoj palët  
5 të mos diskutojnë hollësi -- për këtë hollësi sot.

6 Dua të dëgjoj palët për pikat që unë ngrita, duke përfshirë  
7 dy dokumentet të nxjerrë në bazë të rregullit F141 dhe F171,  
8 përkatësisht, në bazë të cilit rregull ato do të përdoren në gjyq,  
9 dhe nëse ka ndonjë kundërshtim nga Mbrojtja për të shtuar  
10 dokumentin 095162-095239 në listën e provave materiale;

11 Dhe pastaj, nëse ZPS-ja e ka përfunduar nxjerrjen sipas -- e  
12 materialit në bazë të rregullit 103 deri në afatin e përcaktuar 9  
13 prill '21, apo nëse priten nxjerrje të tjera në bazë të këtij  
14 rregulli, sidomos duke pas parasysh parashtrimet e lartpërmendura  
15 nga Mbrojtja e Haradinajt;

16 Nëse ZPS-ja ka një vlerësim të kohës, nëse ka, se kur të  
17 zgjidhet kërkesa e palës së tretë;

18 Nëse ZPS-ja synon të shtojë prova sipas rregullës 102(2) dhe  
19 a mund të japë arsye për nxjerrjen me vonesë, nëse do të ndodhë  
20 kështu;

21 Dhe kur ZPS-ja planifikon të më nxjerrë mua, si Gjykatës i  
22 Procedurës Paraprake, ndonjë version të paredaktuar të provave të  
23 nxjerra sikurse urdhërohet në vendimin kuadër mbi Mbrojtjen, F104,  
24 paragraf 80;

25 Dhe së fundi, ndonjë pikë të mëtejshme për aftësinë e -- për

1 mundësinë e Mbrojtjes për të parashtruar kundërshtimet e saj, nëse  
2 ka, për materialin provë të nxjerrë në bazë të rregullës 102 siç  
3 parashikohet në rregullën 95(2) (e);

4 Dhe së fundi, më në përgjithësi, duhet të di nëse palët po  
5 hasin ndonjë vështirësi apo parashikojnë ndonjë vështirësi lidhur  
6 me pjesën tjetër të procesit të nxjerrjes, veçanërisht në lidhje  
7 me rregullin 102(3) -- me materialin në bazë të rregullit 102(3).

8 Ju kërkoj ndjesë për këtë fjalim kaq të zgjatur.

9 Tani do t'ju jap juve fjalën, duke e filluar me ju zoti  
10 prokuror. Në qoftë se keni nevojë t'ju kujtoj se për ç'pikë duhet  
11 të flisni, më lejoni t'jua them. Keni fjalën.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Do  
13 të përpiqem. Po të kem nevojë për ndihmë, do t'ju them.

14 Së pari do t'i përgjigjem suaj të parë lidhur me ato  
15 deklaratat që përshkruat që futen në rregullin -- në bazë të  
16 rregullit 141 dhe 171.

17 Deklarata sipas vendimit 141 është në listën tonë, sepse  
18 është nxjerrë në bazë të rregullës 102(1) (b).

19 E njëjta gjë mund të thuhet edhe për deklaratën që futet në  
20 bazë të rregullit 171, me ndryshimin që ai përfundoi mbas 9  
21 prillit që ishte afati, prandaj kemi paraqitur një kërkesë që këtë  
22 pikë ta shtojmë në listën e provave. Kjo është arsyeja pse këto dy  
23 materiale janë nxjerrë në bazë të rregullës 102(1) dhe (b). Siç ju  
24 thatë me të drejtë, kishte disa gabime në deklaratën e parë të  
25 cilat janë vënë në dukje në të dytën.

1 Për sa i takon rregullit 103, - e thamë -- e kemi thënë - ne  
2 besojmë se kemi nxjerrë gjithçka që futet në kuadrin e atij  
3 rregulli, dhe e dimë që Mbrojtja kërkon të dijë nga ne në qoftë se  
4 e kemi bërë këtë gjatë parashtrimeve në konferencën mbi ecurinë e  
5 çështjes. Konstatoj në veçanti se kodi i redaktimeve A7, B5, E,  
6 për paketën e materialeve 23 -- të 23, 22 prillit.

7 Vendimi kuadër na lejon të bëjmë kërkesë për materiale në  
8 bazë të një kategorie të paramiraturar. Kategoria A7 dhe B5 janë  
9 redakte standarde të cilat mund t'i përdorim pa autorizim të  
10 mëparshëm. Kategoria 3 ka të bëjë me redakte jostandarde, të  
11 cilat kërkojnë miratim gjyqësor për t'u zbatuar.

12 Kur teksti shënohet -- kur teksti shënohet me këto kode, do  
13 të thotë se ka tre baza të pavarura për të redaktuar informacionin  
14 në fjalë.

15 Është e paqartë nëse Mbrojtja Haradinaj nxjerr këtë përfundim  
16 nga kodi i redaktimit të identifikuar në paragrafin 7 të  
17 parashtrimeve. Paketa e nxjerrjes 23 përputhet -- ka të bëjë me  
18 nxjerrjen e materialeve me versione më pak të redaktuara të dy  
19 dokumenteve në përputhje me vendimin tuaj. Në lidhje me nxjerrjen  
20 e shënimeve për kontaktet me dëshmitarë që adresojnë ndikimin që  
21 do të ketë tek të akuzuarit, ato nuk kanë të bëjnë me dëshmitarë  
22 që do të thirren në çështjen 7.

23 I nderuar Gjykatës, ju identifikuat katër paragrafë që  
24 kërkojnë më pak redakte, të cilat neve tani i kemi bërë.

25 Si një shembull, në paketën 8 ne nxorëm 108 -- 104 dokumente.

1 Që të gjithë kanë të njëjtin kod, pra, A7, B5, E.

2 Nuk ka dokumente potencialisht shfajësuese në këto redaktime.  
3 Ato janë shënuar me saktësi sipas vendimit tuaj dhe ju i keni  
4 parë.

5 Në lidhje me materialet e rregullës 102(3), është parashtruar  
6 një vendim në bazë të këtij rregulli sipas vendimit tuaj F00172.  
7 Ne zgjodhëm 184 dokumente që lidhen me çështjen sipas kuptimit të  
8 vendimit tuaj. Ne kemi përfshirë 13 dokumente nga njoftimi ynë i  
9 mëparshëm në bazë të rregullit 102(3), si edhe kemi nxjerrë  
10 dokumente të nxjerra më përpara të identifikuara në paragrafin 30,  
11 31.

12 Shumica e këtyre dokumenteve janë kategoria e përgjithshme:  
13 Poste të medias sociale dhe përkthimet në anglisht, përgjithësisht  
14 nga të akuzuarit, të cilat nuk do të përdoren si prova dhe nuk  
15 janë shfajësuese; shënime të ZPS-së, që janë kryesisht --  
16 shpjegojnë se çfarë materiale janë shkarkuar nga interneti; tre,  
17 informacion të mëtejshëm në dokumentet e sekuestruara dhe analiza  
18 e tyre; katër, korrespondenca ndërkombëtare dhe parashtrime të  
19 gjykatës, të cilat janë përfshirë në listën e provave; dhe pesë,  
20 informacion i mbajtur në bazë të vendimit tuaj që -- mbasi morëm  
21 lejen tuaj për ta nxjerrë.

22 Duke shpresuar që këto që thashë janë të qarta, ne kemi  
23 ndjekur parimin e rëndësisë së përgjithshme të tyre kur i kemi  
24 përfshirë. Ju përcaktuat afatin 21 prill, kur Mbrojtja duhet të  
25 parashtrojë kërkesa, në qoftë se ka, duke cituar vendimin tuaj



1 tani, "për nxjerrjen me përparësi apo inspektimin, duke përfshirë  
2 çdo dokument të papërfshirë në njoftimin e hollësishëm të  
3 konsoliduar."

4 Nuk ka ndonjë çështje të pazgjidhur për 106 [sipas  
5 përkthimit] dokumentet në këtë njoftim të konsoliduar, pra, rreth  
6 80 për qind. Këto 146 dokumente, të cilat u ndanë në nënartikuj  
7 përpara nxjerrjes të mërkurën, ose janë nxjerrë, ose janë nxjerrë  
8 me redaktime të bëra -- të vëna në dispozicion për inspektim. Disa  
9 nuk do të nxirren, por gjithmonë në përputhje me rregullin që ju  
10 na keni dhënë. 38 të mbeturat kanë -- janë kundërshtuar lidhur me  
11 materialitetin e tyre apo në bazë të rregullit përkatës.

12 Pra, Mbrojtja e Haradinajt argumenton në parashtrimet e saj  
13 me shkrim se njoftimi i konsoliduar në bazë të rregullës 102(3)  
14 përfshinte përshkrime të paqarta.

15 Së pari, siç thashë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake -- na  
16 urdhëruat që të japim njoftim të hollësishëm që përfshin, dhe po  
17 citoj, "çdo material dhe prova që përfshin por jo të kufizuara në  
18 dokumentet e nxjerra në bazë të rregullit për Gucatin kur ato i  
19 përmbushin kërkesat e lartpërmendura," dhe kjo është nga paragrafi  
20 31 i rregull -- i vendimit të rregullit 102(3).

21 Ne kemi përfshirë pra, dokumente tashmë të nxjerra në  
22 njoftimin e konsoliduar. Kemi ofruar, kemi paraqitur dhe indeksin  
23 për të gjithë palët, ku renditet të gjitha njoftimet. Kur  
24 dokumenti është nxjerrë më përpara, paketa e nxjerrjes së atij  
25 dokumenti mund të gjendet në indeksin që i kemi dhënë Mbrojtjes.

1 Nuk duhet të ketë asnjë paqartësi për statusin e nxjerrjes për çdo  
2 artikull në bazë të rregullit të njoftimit të konsoliduar.

3 Së dyti, përshkrimet në njoftimin e konsoliduar kanë qenë të  
4 mjaftueshme ashtu siç janë paraqitur. Megjithatë, kur ne e  
5 kontaktuam Mbrojtjen për ta pyetur për qartësinë e përshkrimeve të  
6 këtyre 41 dokumenteve, i morëm një nga një të gjitha.

7 Por më e rëndësishmja është që pasi Mbrojtja e Gucatit i  
8 zgjodhi të gjitha ato dokumente që kërkonte në bazë të rregullës  
9 102(3), i pyetëm nëse mund të konfirmonin që ato dokumente që do  
10 të nxirreshin për Gucatin do të nxirreshin edhe për Haradinajn.  
11 Mbrojtja e Haradinajt tha që kjo kishte kuptim në rrethanat  
12 aktuale. Dhe në fakt, të gjitha dokumentet e nxjerra të mërkurën,  
13 deri më 28 prill, iu bënë të njohura dhe Mbrojtjes së Gucatit, dhe  
14 të gjitha ato pra, iu bënë në njëfarë forme të njohura edhe  
15 Mbrojtjes së Haradinajt.

16 Në këtë kuadër, Mbrojtja e Haradinajt kundërshton përshkrimet  
17 në bazë të rregullit 102(3), që i kanë marrë apo që do të marrin -  
18 - do të merrnin disa orë pasi ata bënë këtë parashtrim. Nuk ka  
19 nevojë më për njoftimin e rregullit 102(3) për t'i kuptuar këto  
20 dokumente.

21 Për sa i takon kërkesës për materiale jo në bazë të rregullit  
22 102(3), ideja është që a duhen nxjerrë apo jo. ZPS-ja e ka  
23 kundërshtuar materialitetin e kërkesave të Mbrojtjes së Gucatit,  
24 shumica e të cilave nuk janë të ndryshme nga kërkesat e mëparshme  
25 që ju i hodhët poshtë në bazë të vendimit tuaj F00172.

1 Dua të përqendrohem vetëm në një aspekt sot. Mbrojtja e  
2 Gucatit përsëri kërkon informacion lidhur me si të akuzuarit i  
3 siguruan këto paketa me dokumente. Ky informacion është imaterial  
4 për përgatitjet e tyre.

5 Aktakuza e akuzon të akuzuarin me përhapjen e paligjshme të  
6 informacionit konfidencial. Ajo që ka rëndësi është klasifikimi i  
7 informacionit që ata kanë mbajtur dhe çfarë bënë pastaj me atë  
8 material. Si ata e morën informacionin nuk kundërshtohet -- nuk  
9 akuzohet për këtë gjë. Nuk ka rëndësi fare për çështjen.

10 Ne kemi bërë edhe më parë parashtrime për propozimin e  
11 Mbrojtjes se ZPS-ja një njëfarë mënyre i ka dhënë këto dokumente  
12 për të nxitur apo për ta futur në kurth të akuzuarin. Ne e kemi  
13 përsëritur vazhdimisht se ky parashtrim është pakuptim, pabazë,  
14 por ne duam të theksojmë edhe njëherë pikën lidhur me kërkesat për  
15 nxjerrje.

16 Në qoftë se ZPS-ja kishte ndonjë provë se i akuzuari -- të  
17 akuzuarit ishin nxjerrë -- shtyrë nga zyra jonë apo nxitur, kjo  
18 duhej të nxirrej në mënyrë afirmative në bazë të rregullit 103.  
19 Nuk ishte çështje në bazë të rregullit 102(3). Nuk ishte një gjë  
20 që Mbrojtja duhet ta kërkonte. Fakti që Mbrojtja nuk ka prova të  
21 tilla tregon të vërtetën themelore se nuk ekziston një provë e  
22 tillë.

23 Tani, t'i kthehem materialit të rregullit 102(2), vetëm  
24 shtesa e fundit është parashtruar, është pra, ajo deklarata që u  
25 bë e njohur më 14 prill 2021 dhe përkthimi që u vu në dispozicion

1 të mërkurën. Kjo kërkesë tani është parashtruar. Për arsyet që  
2 kemi deklaruar, mendojmë që nuk ka asnjë dëm që shkaktohet nga kjo  
3 shtesë. Pra, nuk ka as -- nuk kërkohet asnjë material shtesë,  
4 provë shtesë.

5 Ju kërkuat -- na pyetët për kërkesën e palës së tretë. Ne po  
6 bëjmë çmos që të sigurojmë një përgjigje. Ne jemi të vetëdijsëm  
7 se çdo informacion që morëm hyn në detyrimin tonë, është pjesë e  
8 detyrimit tonë për të nxjerrë -- për ta nxjerrë. Në qoftë se ne do  
9 ta përdorim atë informacion në gjyq, do të bëjmë një kërkesë të  
10 ngjashme me atë që bëmë dje, dhe me shpresë do ta bëjmë së  
11 shpejti.

12 Sa i takon versioneve të redaktuara të materialit të nxjerrë,  
13 neve mbajtëm shënim shqetësimit tuaja i nderuar Gjykatës. Dhe në  
14 qoftë se nuk -- kemi të bëjmë me një situatë të versioneve të  
15 paredaktuara -- përkojnë me materialet përkatëse, atëherë do të  
16 njoftojmë palët sipas nevojës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbase një qartësim të vogël sa  
18 i takon tabelave. Do të doja t'ju pyesja në qoftë se juve synoni  
19 që t'i përgatisni dhe t'i paraqisni këto tabela në procesin  
20 gjyqësor?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ne kemi bërë organizimet e  
22 nevojshme që këto tabela të përgatiten nga dëshmitari W04841, të  
23 cilin ne synojmë që ta ftojme në procesin e gjykimit. Pra,  
24 Mbrojtja do të ketë mundësi që të shqyrtojë dhe të marrë në pyetje  
25 dëshmitarin në gjykatë sa i takon informacionit që përmbahet në

1 këtë listë dokumentesh.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.

3 Tani le të kalojmë te Mbrojtja.

4 Z. Rees, fjala për ju.

5 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Së pari, sa i takon  
6 çështjes së kërkesës së ZPS-së për leje për të lënë prova në  
7 listën e provave të tyre dhe për prezantimin e deklaratave të  
8 reja, unë e kuptova që ju i nderuar Gjykatës thatë që do të bëni -  
9 - do të nxirrni një vendim të ri sa i takon kësaj çështjeje.  
10 Megjithatë, neve jemi njoftuar për përmbajtjen e këtyre  
11 dokumenteve shumë vonë. Kërkesat për të shtuar zëra dhe dokumente  
12 në listën e provave janë depozituar vetëm dje, çfarë do të thotë  
13 që është vetëm një ditë përpara kësaj konference për ecurinë e  
14 çështjes.

15 Sipas Rregullores, ne kemi të drejtën që të njoftohemi dhe të  
16 japim një përgjigje për këtë mocion me shkrim brenda 10 ditëve,  
17 kështu që do t'ju kërkoja i nderuar Gjykatës që të na jepnit  
18 mundësinë që ta bënim këtë gjë.

19 Për momentin unë nuk jam në pozicion që të jap shpjegime  
20 lidhur me këtë pikë. Kjo nuk është pikë në agjendën e ditës së  
21 sotme apo për vendimin për përcaktimin e konferencës së katërt të  
22 ecurisë së çështjes gjyqësore. Sigurisht që kjo nuk mund të ishte  
23 pjesë e agjendës së gjykatës, i nderuar Gjykatës, sepse në fakt  
24 ZPS-ja e ka ofruar këtë kërkesë vetëm një -- vetëm dje.

25 Kështu që edhe njëherë i nderur Gjykatës do të doja t'ju

1 kërkoja që të na jepnin kohën e nevojshme për të parashtruar një  
2 përgjigje me shkrim për mocionin në fjalë.

3 I nderuar Gjykatës, sa i takon çështjes së nxjerrjes së  
4 materialeve, në qoftë se palët po hasen me vështirësi të tjera të  
5 mëtejshme, ju do ta vlerësonit besoj se në kohën kur unë kam  
6 hartuar përgjigjen për urdhrin për përcaktimin e datës së ecurisë  
7 -- së konferencës për ecurinë e çështjes, ne kemi marrë rregullën  
8 e rishikuar 102(3) që përfshin në të 148 dokumente, dhe, siç e  
9 kemi thënë më përpara, kjo është në kundërshtim me njoftimin  
10 paraprak apo fillestar që ka thënë ZPS-ja, i cili përfshin vetëm  
11 13 dokumente, dhe për të cilin ZPS-ja insistoi në mënyrë  
12 jokorrekte, po gjithsesi insistoi që ky ishte informacioni i cili  
13 ata kishin në dispozicion dhe që nuk e kishin nxjerrë.

14 Rezulton që ata nuk e kishin këtë informacion të saktë, dhe  
15 po ashtu u identifikuan edhe disa pragje apo disa dokumente të  
16 tjera të cilat nuk ishin përfshirë në dokumentacion fillestar të  
17 ZPS-së.

18 Ne mbetemi skeptik sa i takon sigurimeve të tjera në vijimësi  
19 nga ZPS-ja dhe të bëra nga ana e saj. Ne në kohën e hartimit të  
20 përgjigjes së shkruar për sa i takon urdhrin për caktimin e  
21 konferencës së katërt për gjendjen e çështjes, u përgjigjëm në  
22 përputhje me rregullën e rishikuar 102(3) dhe i jemi përgjigjur  
23 vendimit tuaj.

24 Pra, bërja e kërkesës për materiale ka qenë pjesë e  
25 përgjigjes tonë, dhe po ashtu kemi ngritur mangësi të cilat ne

1 kemi identifikuar në njoftim duke ofruar detaje të mëtejshme të  
2 cilat kanë të bëjnë me kërkesa të cilat janë përshkruar si kërkesa  
3 A dhe kërkesa B prej jush, i nderuar Gjykatës. Në kuadër të  
4 komenteve tuaja në vendimin për rregullën 102(3), neve kemi shtuar  
5 nevojën për më tepër detaje për këtë kërkesë në mënyrë që ZPS-ja  
6 pra, të jepte përgjigjet përkatëse.

7 Në momentin e hartimit, dhe neve edhe sot e kësaj dite, nuk  
8 është se kemi marrë një përgjigje për këto kërkesa, dhe madje as  
9 kemi marrë një njoftim nga ZPS-ja që ata e kanë marrë këtë kërkesë  
10 tonën.

11 Është e drejtë të thuhet se ne kemi marrë më 29 prill,  
12 d.m.th., vetëm dje, nxjerrje të tjera të materialeve, dhe bëhet  
13 fjalë specifikisht për 153 dokumente të tjera. Kjo ndodh në  
14 rrethana të tilla kur në mënyrë të përsëritur gjatë tri  
15 konferencave të mëparshme për ecurinë e çështjes, dhe në veçanti  
16 në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes, ju i nderuar  
17 Gjykatës, pra, keni siguruar që nxjerrja e informacionit të ishte  
18 e plotë dhe se ZPS-ja kishte përmbushur plotësisht detyrimet e  
19 tyre për t'i bërë, pra, nxjerrjet -- për t'ia vënë nxjerrjet në  
20 dispozicion palëve. Dhe pavarësisht kësaj, një ditë përpara  
21 konferencës së katër për ecurinë e çështjes neve na ofrohen 153  
22 dokumente të nxjerra prej ZPS-së.

23 Nuk është se po kritikoj faktin që janë nxjerrë kaq shumë  
24 dokumente, por gjithsesi do të doja ta nxirrja këtë gjë, që besoj  
25 që kemi mirëbesimin tuaj i nderuar Gjykatës, që ne mbetemi skeptik

1 sa i takon rrethanave ndërkohë që neve ZPS-ja na siguron në  
2 vijimësi që ushtrimi i nxjerrjes së informacioneve është i plotë.

3 Po ashtu kemi marrë, pas hartimit të parashtrimit tonë me  
4 shkrim që lidhet me këtë konferencë për ecurinë e çështjes,  
5 versionin konfidencial të redaktuar të kërkesës së Prokurorisë dhe  
6 kundërshtimeve që merren me disa prej çështjeve ende pezull të  
7 nxjerrjes së dokumenteve, për të cilat juve i nderuar Gjykatës na  
8 kërkuat që të trajtohen në përputhje me rregulloret dhe përmes  
9 parashtrimeve me shkrim.

10 Pavarësisht që juve na kërkuat që të bënim këtë gjë, sot ZPS-  
11 ja dha parashtrime të tjera me gojë. Dhe unë personalisht nuk  
12 është se do të futem në detaje për këto çështje, por thjesht do  
13 t'i japim përgjigje me shkrim sa i takon kërkesave dhe sfidave,  
14 kundërshtimeve të versionit të redaktuar konfidencial, dhe do të  
15 përgjigjemi me shkrim sipas parashkrimeve ligjore, edhe do të  
16 përgjigjemi në detaje lidhur me çështjet e ngritura.

17 Megjithatë, për aq kohë sa ZPS-ja sot sërish ngriti çështjen  
18 e nxitjes, siç bën zakonisht, siç do të thoshte Shekspiri, do të  
19 duket që protesta është e tepërt nga ana e ZPS-së. Neve do të  
20 hetojmë më tej çështjen e nxitjes dhe të nxënit në kurth, dhe me  
21 formulimin e ZPS-së si në konferenca të mëparshme për ecurinë e  
22 çështjes edhe në parashtrimet me shkrim, pra, ne do të japim pra,  
23 përgjigjet tona dhe do t'i kërkojmë ZPS-së që të mbështetet në  
24 njoftimin e parashikuar në rregullën 102(3).

25 Dhe me informacionin që kemi tregohet që materiali ka



1 rrjedhur nga stafi i ZPS-së apo persona të tjerë të cilët janë të  
2 asociuar, janë të lidhur me ZPS-në. Neve pa diskutim që do t'i  
3 trajtojmë më tej këto çështje në përgjigjen me shkrim, në  
4 versionin konfidencial të redaktuar të kërkesave të Prokurorisë  
5 edhe kundërshtimeve të ngritura prej saj.

6 Sa i takon pyetjes tuaj për ngritjen e kundërshtimeve për  
7 materialin provues, neve e kemi thënë edhe më përpara dhe do të  
8 duam që ta theksojmë edhe njëherë që ne duam që të ngremë  
9 kundërshtimet e identifikuara në këto dokumente deri më 14  
10 qershor, që është data e cila është përcaktuar prej jush i nderuar  
11 Gjykatës për sa i takon ofrimit dhe parashtrimin të dosjes  
12 paragjyqësore.

13 Qartësisht, vlerësimi i pranueshmërisë së provave është një  
14 proces në vijim e sipër. Ne do të bëjmë më të mirën tonë të  
15 mundshme që të mund të identifikojmë kundërshtime të tilla siç --  
16 ato janë të qarta deri në këtë pikë. Por megjithatë, edhe në qoftë  
17 se do të kemi kundërshtime të tjera të cilat do të na dalin më  
18 pas, ne do të bëjmë parashtrimet e tyre në momentin e duhur.

19 Të njëjtin argument do ta nxirrja dhe në lidhje me nxjerrjen  
20 e dokumenteve. Ne kemi bërë më të mirën tonë që sa më shpejt të  
21 jetë e mundur, të mund të bëjmë kërkesa për nxjerrjen e  
22 informacionit, lidhur me informacionet edhe dokumentet që mund të  
23 identifikoheshin prej nesh mbështetur në çështjet e ngritura. Këtë  
24 gjë e kemi bërë. Besoj që e kujtoni edhe ju i nderuar Gjykatës që  
25 këtë gjë e kemi filluar ta bëjmë që prej konferencës së parë për

1 ecurinë e çështjes. Këtë punë do të vazhdojmë ta bëjmë dhe më tej.

2 Por mbetet ende fakt që nxjerrja dhe detyrimet për të bërë  
3 nxjerrje të dokumentacioneve janë të parashikuara në nenin 21(6)  
4 të Ligjit për Rregulloren edhe janë detyrime të Prokurorisë për  
5 t'u përmbushur, dhe si të tilla nuk mund të bëhen objekt i  
6 shkurtimeve ose i paplotësisë.

7 Nuk e di i nderuar Gjykatës nëse doni që të vijoj më tej me  
8 çështjen e aksesit të dokumentacionit nga i akuzuari, apo ndonjë  
9 pikë tjetër të ngritur prej jush i nderuar Gjykatës?

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, jo për momentin. Kjo është  
11 një çështje e cila do të trajtohet pak më vonë në konferencë. Pra,  
12 nuk e di në qoftë se keni ndonjë tjetër lidhur me çështjen e  
13 nxjerrjes. Z. Rees, ndonjë gjë tjetër për të thënë?

14 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam gjë  
15 tjetër për të shtuar për momentin.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë atëherë.

17 Tani i drejtohem z. Cadman.

18 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit, i  
19 nderuar Gjykatës.

20 Më lejoni të them që ka shumë pak gjëra që mund të shtoj,  
21 pasi të gjitha gjërat janë parashtruar në parashtrimet tona me  
22 shkrim edhe të cilat u ngritën me shumë elokuencë edhe nga z. Rees  
23 më parë.

24 Neve i bashkohemi pozicionit të shprehur më parë që ne duhet  
25 të na jepet mundësia që të përgjigjemi brenda afatit kohor të

1 parashikuar, dhe do ta bëjmë këtë gjë.

2 Sa i takon çështjes se ZPS-ja ka deklaruar në vijimësi lidhur  
3 me nxitjen apo akuza të tjera të cilat janë ngritur kundër ZPS-së  
4 dhe është shprehur në vijimësi për ta, dhe pohimi i tyre që nuk  
5 ekzistojnë prova të cilat janë nxjerrë, ne, i nderuar Gjykatës, e  
6 kemi deklaruar shpeshherë që arsyeja sepse pra, këto të thëna dhe  
7 këto dokumente janë në ZPS d.m.th., e gjithë origjina e të gjithë  
8 këtij -- kësaj çështjeje është nga -- rrjedh nga pozicioni i ZPS-  
9 së që asnjëherë ajo nuk e ka marrë seriozisht hetimin apo  
10 shqyrtimin e rrjedhjes së informacionit.

11 Kështu që besoj që në këtë kuadër është absolutisht shumë e  
12 rëndësishme që çdo informacion që ka ZPS-ja të mund të nxirret për  
13 palët. Dhe në qoftë se nuk janë bërë hetime deri tani, i nderuar  
14 Gjykatës, ne do të donim të dinim se pse nuk janë bërë hetime sa i  
15 takon rrjedhjes së informacionit deri tani.

16 Siç e kam thënë edhe më parë - është dërguar një listë prej  
17 39 kërkesave për ZPS-në - që janë ose mbështetur në hetimet tona  
18 që na kanë treguar që ZPS-ja, ose ndoshta nuk ka kryer një hetim  
19 serioz që duhet të kishte kryer në një çështje të tillë, ose ZPS-  
20 ja vazhdon -- d.m.th., ndërkohë që ZPS-ja vazhdon që të akuzojë  
21 pra, klientët tanë.

22 Pra, me fjalë të tjera, do të duhet i nderuar Gjykatës që të  
23 dëgjojmë sa i takon hetimeve që ka bërë ZPS-ja sa i takon  
24 rrjedhjes së informacionit prej saj. Dhe kjo është një çështje që  
25 Mbrojtja do ta ndjekë dhe ka të drejtë ta ndjekë në vijimësi. Këto

1 çështje mbeten ende për t'u shqyrtuar edhe për t'u zgjidhur.

2 I nderuar Gjykatës, ne kemi parashikuar dhe kemi parashtruar  
3 atë çfarë besojmë që kemi pozicion të qartë nga paragrafi pesë --  
4 i pestë dhe në vijim. Sa i takon pikës së parë që po shqyrtojmë  
5 tani, kërkesat lidhur me të ju janë parashtruar tashmë.

6 Do të doja të theksoja dhe njëherë atë çfarë tha z. Rees, që  
7 neve po na kërkohet në mënyrë efektive që të pranojmë pozicionin e  
8 ZPS-së me vlerë të parë pra, d.m.th., vetëm thjesht duke besuar  
9 fjalën e tyre pa bërë asnjë lloj, le të themi, kontrolli apo --

10 Dhe neve e kemi thënë, siç e tha me të drejtë z. Rees që,  
11 këto janë çështje të cilat deri tani nuk janë trajtuar ashtu siç  
12 duhet dhe që do të kërkojnë ndërhyrjen tuaj i nderuar Gjykatës.  
13 Kështu që këto çështje do të duhet që të shqyrtohen, sepse nuk  
14 mund të marrim si bazë vetëm fjalën e ZPS-së pa bërë hetime të  
15 tjera të mëtejshme apo kontrole të mëtejshme. Këto janë çështje  
16 që do të doja të ngrija për momentin.

17 Pra, kjo është ajo çfarë doja të thosha për pikën e parë të  
18 agjendës. Siç e tha z. Rees, kjo nuk është hera e parë që ZPS-ja  
19 ka nxjerrë apo ka disa dokumente që i ka vënë në dispozicion një  
20 ditë përpara konferencës për ecurinë e çështjes, gjë e cila e bën  
21 shumë të vështirë për neve që të bëjmë parashtrimet e duhura me  
22 gojë para jush i nderuar Gjykatës, pa pasur kohën e nevojshme për  
23 t'u përgatitur dhe për të dhënë përgjigjet tona. Kështu që do të  
24 duhet që të përdorim afatin kohor në dispozicionin tonë, që është  
25 dhjetë ditë, në mënyrë që të mund që të mund t'i përgjigjemi siç

1 duhet.

2 I nderuar Gjykatës, do ta përfundoj me kaq. Sigurisht që do  
3 ta marr fjalën më pas lidhur me çështjet e tjera që do të duhen të  
4 shqyrtohen sot dhe që kërkojnë ca diskutim, përfshirë këtu aksesin  
5 në dokumente dhe në përkthime.

6 Ju kërkoj ndjesë i nderuar Gjykatës që ju kam dërguar një  
7 parashtrim sot në mëngjes, dhe që palët nuk kanë pasur mundësi që  
8 ta shqyrtojnë këtë parashtrim tonin, por ky parashtrim mbështetet  
9 mbi aspekte të parashtrimeve të ZPS-së dhe të Zyrës së  
10 Administratores. Megjithatë, kam përshtypje që këtë çështje do ta  
11 trajtojmë më vonë në më tepër thellësi.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman. Po,  
13 materiali juaj është parashtruar një minutë përpara sesa të  
14 fillonte seanca, kështu që as nuk kam pasur mundësi fare ta hap  
15 atë.

16 Zoti prokuror, dëshironi t'i përgjigjeni Mbrojtjes?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Pra,  
18 megjithatë nuk do të përdor citime të Shekspirit se nuk mendoj që  
19 do t'i citoj siç duhet.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] As unë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk presim që Mbrojtja të na  
22 pranojë neve vetëm duke u mbështetur në fjalët tona dhe vetëm pra,  
23 duke u mbështetur në parashtrimet tona. Po ata pa diskutim që kanë  
24 të drejtë që të bëjnë ato kontrollet e tyre, edhe kjo duhet të  
25 vendoset prej jush i nderuar Gjykatës.

1 E vetmja gjë që dua të trajtoj unë ka të bëjë me korigjimin  
2 e asaj çfarë u tha nga zoti -- nga Mbrojtja e z. Gucati.

3 Dokumentet që përmendim janë dokumentet që në fakt neve kemi  
4 nxjerrë më datë 28 prill.

5 Dhe unë përmenda gjithashtu edhe shifrën 146, ndërkohë që  
6 numri që u përmend nga Mbrojtja e z. Gucati është pak më i lartë.  
7 Arsyeja për këtë gjë është që - siç e shpjegova pak më përpara -  
8 një pjesë e mirë e këtyre dokumenteve janë nxjerrë si nënkategori.  
9 Dhe jo vetëm kaq, por ka pasur gjithashtu edhe dokumente të  
10 kufizuara të mënyrë që të siguroheshim që skuadrat e Mbrojtjes të  
11 kishin një version dhe ne kemi dhënë një version të redaktuar për  
12 të dyja ekipet, dhe në fakt data është data që është përcaktuar si  
13 afat kohor prej jush.

14 Tjetra gjë që do të doja që të përmendja është diçka që është  
15 bërë si refren nga Mbrojtja e z. Haradinaj, që ne nuk e kemi  
16 hetuar sa duhet këtë çështje. Pra, e di që e kam thënë këtë gjë më  
17 përpara, kështu që do t'i bie shkurt.

18 Më lejoni të them që hetimet tona kanë vërtetuar që akuzat e  
19 ngritura kundër të akuzuarit janë të përlligjura dhe prova ka të  
20 mjaftueshme për të provuar fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm.  
21 Aktpadia tashmë është e konfirmuar dhe thuajse faza e paragjyimit  
22 ka përfunduar.

23 Mbrojtja nuk duhet të vendosë se çfarë duhet të hetojë ZPS-ja  
24 apo çfarë nuk duhet të hetojë ajo, dhe as nuk duhet të vendosë se  
25 cilët janë dëshmitarët që do të thërrasim apo çfarë provash do të

1 paraqiten në gjyq. Është përgjegjësia jonë si ZPS që të  
2 parashtrojmë prova që ne i konsiderojmë më të mirat dhe më të  
3 shëndoshat për të vërtetuar barrën e provës, dhe në fund do t'i  
4 takojë Trupit Gjykses për të vendosur në qoftë se informacioni për  
5 të deklaruar fajtor të akuzuarin është i mjaftueshëm apo jo.

6 Kjo nuk është çështje që i takon Mbrojtjes, kjo është çështje  
7 që na takon neve edhe juve z. Gjykatës. Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja, keni diçka për të  
9 shtuar?

10 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

12 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, faleminderit i  
13 nderuar.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Disa gjëra për pikën e parë lidhur me nxjerrjen e  
16 materialeve. Nuk do të jap ndonjë urdhër me gojë për kërkesën e  
17 ZPS-së, duke pasur parasysh kërkesën e Mbrojtjes për të pasur  
18 dhjetë ditë në dispozicion për t'u përgjigjur me shkrim. Këtë  
19 kërkesë do ta trajtojmë me vendim me shkrim sipas rregullës 76.

20 Gjithashtu do të trajtojmë kërkesën e ZPS-së lidhur me  
21 materialitetin me vendime me shkrim. Prandaj u ftoj të gjithëve që  
22 të ndiqni afatet e parashikuara në rregullën për atë.

23 I ftoj palët të vazhdojnë dialogun midis tyre *inter partes*. E  
24 shoh që nuk është gjithmonë e lehtë, por megjithatë dëshiroj që të  
25 gjithë të vazhdojnë me mirëbesim. I ftoj palët që të më drejtohen

1 me shkrim nëse hasin vështirësi të mëdha dhe, nëse është e mundur,  
2 përpara konferencës së ardhshme, që unë t'i trajtoj këto çështje  
3 në kohën e dukur, dhe sidomos për të respektuar kalendarin që unë  
4 vetë e kam përcaktuar në mars, nëse mundemi, që unë kam ndërmend  
5 ta bëj.

6 Kjo për -- kaq ishte për sa i takon nxjerrjes. Oh, z. Rees.

7 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Përpara se të  
8 kalojmë te pika tjetër, dua veç të ngre një çështje të  
9 zbatueshmërisë lidhur me objektin e -- me objektin rimout?

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Këtë do ta trajtoj me -- në  
11 konferencën tjetër.

12 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk është e lidhur.  
13 Kjo lidhet me konferencën për ecurinë e çështjes dhe si ta  
14 trajtoj. Më lejoni ta shpjegoj shumë shkurt ju lutem.

15 Kur ato që ishin në objektin e largët dhe janë drejtuar nga  
16 larg -- kur iu kanë drejtuar gjykatës nga larg, ne nuk i shohim.  
17 Ajo që shohim ne janë vetëm pjesëmarrësit që janë 'online', që na  
18 e bën të vështirë që të angazhohemi si duhet me gjykatën sepse  
19 është shumë më e lehtë ta shohësh personin të cilit i drejtohet.  
20 Ka ndonjë mënyrë që ta zgjidhim këtë problem? Pra, që të tregojë  
21 personin që flet dhe jo vetëm juve.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'ia jap fjalën Zyrës së  
23 Administratës, por më duket se e vetmja mënyrë për ta bërë është  
24 që po të kishim këtu nga salla e gjyqit disa lidhje me ZOOM, sepse  
25 për momentin ju keni atë që ne e quajmë lidhja me sallën, ajo që



1 transmetohet në internet. Në fakt, ju nuk i keni të gjitha  
2 kamerat, që do të thotë se ne në të njëjtën kohë kemi disa lidhje  
3 me ZOOM, një kamera drejtohet nga unë, dhe një te palët e  
4 ndryshme, ke pjesëmarrësit. Nuk e di nëse është e mundur të  
5 realizohet kjo që thoni ju.

6 Z. Cadman, mbase ju keni diçka.

7 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo. Nuk marr vesh  
8 shumë nga teknika unë, por besoj që ka mënyra sesi mund të  
9 rregullohet kjo punë. Është një vështirësi për ata që s'janë  
10 fizikisht të pranishëm, ata që flasin nga larg.

11 Kur flisni ju, unë i shikoj të gjithë tani, siç po flas tani,  
12 po nuk i shikoj ata që flasin nga larg. Pra, besoj që ka një  
13 mënyrë teknike sesi mund të manipulohet kjo gjë edhe duke e ndarë  
14 ekranin.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Roche, është e mundur? Nuk do ta zgjidhim sot sigurisht,  
17 po a ekziston mundësia? Apo ju punonjëse e gjykatës.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për të konfirmuar atë që  
19 tha z. Cadman, ashtu është. Në qoftë se Mbrojtësi zgjedh 'gallery  
20 view' pra, pamjes si galeri, mund ta shikojë atë që transmetohet  
21 këtu, atë që ndodh këtu në sallën e gjyqit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Roche, keni diçka?

23 Z. ROCHE: [Përkthim] Nuk mund të them asgjë lidhur me këtë  
24 çështje, por do ta hetojmë dhe do t'ju raportojmë sa më shpejt që  
25 të mundemi.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roche.

2 Ftoj Zyren Administrative të shohë nëse mund të gjendet një  
3 zgjidhje për konferencën e ardhshme. Do të përpiqemi të gjejmë një  
4 mënyrë. E kuptoj, sepse edhe unë vetë e kam menduar në konferencat  
5 e tjera. Duke pas parasysh ato që shoh unë edhe ju shikoni të  
6 njëjtat, duhet të jetë diçka e vështirë. E kuptoj se ju nuk e  
7 shikoni sallën e gjyqit. Pra, do të përpiqemi të gjejmë një  
8 zgjidhje për konferencën e ardhshme.

9 Po i kthej sytë nga tekniku që me -- teknika me -- sigurisht  
10 që do të më urrejnë që po u jap një detyrë të tillë, po ju lutem  
11 që të gjejnë një zgjidhje.

12 Nëse nuk ka gjë tjetër, do të kalojmë te pika e dytë në  
13 programin tonë, që është qasja e të akuzuarve në dokumente.

14 Në parashtrimet e tij -- e saj, Administratorja kujtoi se  
15 sistemi i sigurt i shkëmbimit të të dhënave elektronike,  
16 shkurtimisht SEDS, është në rregull, është -- punon për shkëmbimin  
17 elektronik të materialeve midis të akuzuarve dhe mbrojtësve të  
18 tyre.

19 Por, sipas Mbrojtjes së Gucatit, sistemi SD -- kapaciteti i  
20 këtij sistemi SEDS është shumë i vogël dhe duhet zgjeruar, dhe  
21 Legal Workflow pra, sistemi duhet të ofrojë mundësinë që të  
22 shkarkohen skedarë të dokumenteve të nxjerra në tërësinë e tyre,  
23 apo për t'i transmetuar ato si një paketë e vetme në SEDS.

24 Konstatoj se Mbrojtja e z. Haradinaj gjithashtu mendon që kjo  
25 SEDS-ja nuk është shumë e madhe për të ngarkuar të gjitha provat,

1 sidomos ato që janë në video, dhe prandaj kërkon mundësinë të  
2 përdorë mjete alternative siç mund të ishin USB-të që janë të  
3 sigurt.

4 Gjithashtu konstatoj se Mbrojtja Haradinaj vlerëson se  
5 komunikimi midis mbrojtësve dhe klientëve në objektin e burgimit -  
6 - janë të komplikuar për shkak të arrestimit -- për shkak të  
7 ndarjes midis të pandehurit dhe mbrojtësit.

8 Gjithashtu, ftoj Zyrën e Administratës të ofrojë hollësi për  
9 kapacitetin e SEDS-së pra, të këtij sistemi, lidhur me mundësinë  
10 për të përdorur USB-të për transferimin e informacionit dhe  
11 komunikimin midis të pandehurve dhe mbrojtësve në objektin e  
12 paraburgimit.

13 Z. Roche, keni fjalën.

14 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit shumë i nderuar.

15 Siç e dini, Zyra e Administratës ka bërë një parashtrim për  
16 këtë çështje më 28 prill, dhe do t'i referohem atij por do të  
17 shtoj edhe disa gjëra për t'iu përgjigjur pyetjes.

18 Së pari, sistemi SEDS, ai është në rregull, punon që në  
19 fillim të marsit, dhe të dy ekipet e Mbrojtësve janë futur në të.  
20 Kapaciteti aktual është 25 gigabajt për përdorues, për mbrojtësit  
21 dhe për secilin prej anëtarëve të ekipeve të tyre dhe për të  
22 akuzuarit. E kemi rritur tani kapacitetin në 100, katër herë më  
23 shumë gigabajt që lejon shumë -- futjen e shumë më tepër  
24 materialeve.

25 Përgjithësisht lidhur me përdorimin e SEDS-së dhe

1 transferimin e dosjeve, gjatë trajnimit të dhënë mbrojtësve u  
2 shpjegua hap pas hapi sesi të transferonin dokumente të shumta nga  
3 Workflow, sistemi Workflow në sistemin SEDS. Është një çështje e  
4 thjeshtë teknike që përfshin zgjedhjen e dokumenteve.

5 Dhe në këtë rast i sugjeroj mbrojtësve që dua -- nëse duan të  
6 kenë më shumë informacion, të kontaktojnë Njësinë e Menaxhimit të  
7 Gjykatës, dhe ata me siguri do t'u japin ndihmë.

8 Për sa i takon përdorimit të USB-ve, politika aktuale e  
9 sigurisë nuk lejon sjelljen e shumë artikujve të tillë në objektin  
10 e paraburgimit, dhe jepet një listë e gjatë, armë, eksplozivë,  
11 mjekime të paautorizuara, e të tjera, dhe nga këto USB-të.

12 Pra, do të angazho -- unë kam bërë disa konsultime me Njësinë  
13 e Informacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe do të shikojmë  
14 nëse mund të shmangemi nga ky ndalim i përgjithshëm që t'u  
15 mundësojmë mbrojtësve të sjellin USB për dhënien e dokumenteve  
16 klientëve të tyre. Kjo do të kërkojë disa konsultime të mëtejshme  
17 me shërbimet përkatëse të administratës. Do të diskutohet me  
18 Administratoren e cila është personi që ka autoritetin të  
19 ndryshojë politikën aktuale.

20 Shpresoj që kjo do të -- me gjithë vështirësitë të zgjidhet  
21 me urdhër relativisht të shkurtër. Do ta -- do t'i japim trajtimin  
22 që meriton me shumë urgjencë pra.

23 Çështja tjetër që ngriti Gjykatësi i nderuar lidhur me  
24 komunikimin midis mbrojtësve dhe të akuzuarve në paraburgim, në  
25 bazë të masave aktuale gjithçka varet në bazë të këshillave

1 mjekësore të pavarura të ofruara nga -- Zyrës së Administratës nga  
2 shërbimi mjekësor dhe që vlejné për të gjithë, për shërbimet e  
3 tribunaleve që kanë të paraburgosur në Njësinë 4. Këto çështje  
4 duhet të vazhdojnë sepse kanë të bëjnë me mbrojtjen e të gjithëve  
5 dhe janë zbatim i politikës sonë për të mbrojtur shëndetin e të  
6 gjithë personave që janë të pranishëm në objektet e paraburgimit.  
7 Pra, në këtë moment do të thosha se këto janë të mjaftueshme --  
8 janë të nevojshme për të lejuar kontaktet midis mbrojtësve dhe të  
9 akuzuarve në këtë moment.

10 Besova -- besoj që ju dhashë informacionin e duhur.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

12 Kjo e fundit që thatë ka të bëjë me pandeminë. E falënderoj  
13 Administratën që e ka përmirësuar sistemin, që e ka ngritur  
14 kapacitetin deri në 100 gigabajt që mund të zgjedh -- zgjidhë një  
15 pjesë të problemit, sidomos kur lidhet me provat në video.

16 Tani ia jap fjalën ekipit të Mbrojtjes, duke filluar me z.  
17 Rees.

18 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Është shumë mirë për  
19 ne që e keni rritur këtë kapacitetin e SEDS-së.

20 Në fakt tani duket sikur po funksion sistemi, tani unë mund  
21 t'ju shikoj. Ah, jo.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ah, tani do të më shikoni.

23 Varet nga personi në kabinë që po editon videon. Ai vendos nëse  
24 duhet të më shikosh mua apo jo. Duhet bërë disa përmirësime, sepse  
25 faktikisht duhet të më shikoni. Këtë -- duhet të shikoni këtë që

1 shikoni tani, plus të gjithë pamjen që krijohet me ZOOM. Pra, u  
2 kam dhënë njëfarë pune Njësisë Teknike.

3 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Pra, jam shumë  
4 mirënjohës për rritjen e kapacitetit të SEDS-së. Ka disa hollësi  
5 teknike që mbase në këtë fazë nuk do të ishte e dobishme t'i  
6 trajtoja, por mund të flas më në përgjithësi.

7 Z. Roche përmendi trajnimin për Legal Workflow, ndihmën për  
8 të na treguar sesi mund të shkarkohen një numër dokumentesh në  
9 tërësinë e tyre si bllok. Z. Roche ka të drejtë, unë e kam bërë  
10 këtë trajtim, ishte shumë i dobishëm dhe jam shumë mirënjohës  
11 sepse ma shtoi njohurinë për këtë sistemin Workflow. Por edhe  
12 rregullimi, në qoftë se mund të them, që u përmend, të kërkon të  
13 futesh në skedarin e nxjerrjen duhet -- brenda atij skedari duhet  
14 të zgjerosh -- të futesh nëpër dosje - dhe maksimumi është 100  
15 dosje - pastaj duhet të klikosh që të zgjedhësh secilën prej  
16 këtyre dosjeve, pastaj të shkosh ke funksioni që thotë 'download'  
17 shkarkim.

18 Këtë nuk e bën dot për parashtrimet. Ato duhet -- për ato  
19 duhet të futesh një nga një, t'i zgjedhësh një nga një sepse ato  
20 kanë një skedar të veçantë. Nuk ka sesi, të paktën si e kuptoj  
21 unë, që t'i shkarkojmë parashtrimet në bllok, dhe ju e dini sesa -  
22 - për sa shumë bëhet fjalë në këtë rast.

23 Për sa i takon mundësisë për të transferuar dosje nga sistemi  
24 Workflow ke sistemi SEDS, siç kam thënë në parashtrimet me shkrim,  
25 do të ishte shumë me dobi për ne nëse do të kishte një rrugë më të

1 lehtë që thjesht të zgjidhje skedarët e materialeve të nxjerra dhe  
2 t'i kopjoje si skedarë apo t'i tërhiqje e t'i çoje ke sistemi  
3 SEDS. Dhe po ashtu nëse ka një mënyrë për t'i shkarkuar -- atë  
4 skedarin e parashtrimeve i përgjithshmi 'on bloc', pra, në bllok.  
5 Kjo do të ishte një ndihmë shumë e madhe për ne.

6 Unë do të isha mirënjohës për çdo përpjekje për të na  
7 ndihmuar në këtë drejtim, edhe besoj që ata që janë përgjegjës për  
8 këtë punë po dëgjojnë dhe do t'u përgjigjen këtyre problemeve --  
9 zgjidhjes së këtyre problemeve. Do t'u isha mirënjohës në qoftë se  
10 do ta merrni parasysh më -- pra, që ne të mund të shkarkojmë  
11 skedarët në tërësi.

12 Për sa i takon kushteve në objektin e paraburgimit, ne kemi  
13 mundur të kemi qasje te z. Gucati. Ne e kuptojmë sepse është  
14 vendosur ai ekрани prej xhami, por megjithatë na pengon që të  
15 flasim si duhet me z. Gucati. Ju e kuptoni sesa e rëndësishme  
16 është që avokati dhe klienti të mundet të ulen bashkë, t'i shohin  
17 bashkë dokumentet, gjë që është shumë e vështirë kur të ndan një  
18 ndarje prej xhami. Dhe jo vetëm kjo ndarje prej xhami, por është  
19 edhe futur në një mur midis klientit dhe avokatit të tij.

20 Z. Cadman mund të ketë parashtrime më të hollësishme dhe unë  
21 i miratoj ato që ai do t'ju thotë për këtë pikë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

23 Pra, për pikën tuaj të parë, ju doni të keni një "ctrl+A"  
24 pra, të përzgjedhjes së dokumenteve. Unë nuk mund t'ju jap një  
25 përgjigje sot, po do t'i themi Administratës.

1           Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Këta -- qasja  
2 "ctrl+A" pra, që quhet, është e mirë po prapë është e kufizuar.  
3 Prapë duhet të futesh në çdo skedar të materialit të nxjerrë.  
4 Pastaj të ofrohet një opsion sa dosje do të shikosh. Mund të  
5 përdorësh "ctrl+A" për të pra, parë ato që janë në ekran, dhe  
6 maksimumi që mund të shikosh janë 100. Është më mirë se ç'ishte  
7 përpara, por prapë duhet që të hapësh çdo skedar, çdo dritare në  
8 çdo skedar. Këtë proces nuk e bën dot për parashtrimet sepse, siç  
9 thamë, ato janë në skedarë të veçantë.

10           Prandaj kërkoj nëse do të na mundësohet që të zgjedhim një  
11 skedar të tërë të materialeve të nxjerra apo të parashtrimeve.

12           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'i kërkoj Administratës,  
13 Zyrës së Administratës që ta shqyrtojë këtë çështje. Do t'ju jap  
14 përgjigje posa që të kenë një përgjigje. Nuk e di nëse aktualisht  
15 është e mundur, por nëse jo, kjo duhet parashikuar në përditësimin  
16 e ardhshëm të programit kompjuterik. Mund të kërkojë disa  
17 vështirësi -- mund të ketë disa vështirësi. Nuk ju jap dot një  
18 afat për afatin, nuk ju jap dot -- premtoj dot afat.

19           Z. Cadman.

20           Z. Cadman, më thanë që unë dukem tani në ekranin tuaj dhe se  
21 teknika e ka zgjidhur problemin shumë shpejt.

22           Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, po,  
23 faleminderit.

24           I nderuar Gjykatës, nuk dua që ta shtjelloj më tej këtë  
25 çështje pasi kjo është mbuluar në parashtrimet me shkrim, por do



1 të doja që të trajtoja dy, tre çështje të tjera.

2 Pa diskutim jemi shumë mirënjohës që do të mund të ndihmohemi  
3 duke pasur, le të themi, një rritje prej 100 gigabajt të sistemit,  
4 dhe kjo do të na lejonte që të mund të fusnim materiale të tjetra  
5 p.sh., regjistrime në video të cilat do të na duhen në procesin  
6 gjyqësor.

7 Më lejoni të them që e vlerësojmë të gjithë trajnimin që na  
8 është ofruar nga Zyra e Administratorit, por nga ana tjetër, nuk  
9 është vetëm thjesht çështje trajnimi, por është çështje edhe e  
10 dobishmërisë së sistemit. D.m.th., sa i dobishëm dhe sa i thjeshtë  
11 është sistemi për t'u përdorur.

12 Pra, do të doja të theksoja edhe njëherë atë çfarë tha z.  
13 Rees, në kuptimin që do të duhet që të hapësh çdo skedar të  
14 mundshëm, dhe është e rëndësishme që ne të gjejmë një mënyrë  
15 tjetër d.m.th., sesi të bëjmë ruajtjen e këtyre skedarëve të cilët  
16 mund të kenë formate të ndryshme.

17 Por me nxjerrjen e materialeve në veçanti, një prej  
18 vështirësive kryesore me të cilat ne hasemi janë skedarët, pra,  
19 skedarët të cilët kanë numrin e dosjes edhe emrin e dosjes. P.sh.,  
20 ti kur shkarkon dokumentin në formularin ose në formatin PDF  
21 d.m.th., nuk të shfaqet më emri i dosjes në vetvete. Pra, me fjalë  
22 të tjera, të duhet që ti të ndryshosh edhe njëherë të gjithë emrat  
23 e dosjeve në mënyrë që të dimë se cilit dokument po i referohemi.

24 Një mënyrë e thjeshtë për ta korrigjuar këtë problem është që  
25 të kemi një dosje më vete që ka të gjitha dokumentet aty d.m.th.,

1 jo në nëndosje por një dosje e përgjithshme në mënyrë që pastaj ne  
2 mund të bëjmë shkarkimin e të gjithë informacionit, gjë e cila do  
3 të na lehtësonte shumë punën dhe që do të na kursente dhe shumë  
4 kohë në të njëjtën mënyrë.

5 Pra, dhe njëherë, ju lutem mos na keqkuptoni, nuk është se po  
6 mundohemi që të propozojmë diçka që është e pamundur ose që nuk  
7 mund të realizohet, por thjesht po mundohemi që të bëjmë  
8 rekomandime për të lehtësuar punën tonë.

9 Mendoj se është më e vështirë për ne, edhe duhet ta kuptojë  
10 Gjykata që është më e vështirë për ne pra, për ata të cilët nuk  
11 janë në ndërtesë që të punojmë në distancë. Pra, nuk është e  
12 njëjta gjë që të punosh në distancë po -- krahasimisht me atë  
13 çfarë do të ndodhte po të ishim të pranishëm në sallën e gjyqit  
14 apo në gjykatë ku do të ishte e thjeshtë p.sh., që të përdornim  
15 USB-të apo të kishim mbështetjen e departamenteve të shumta të  
16 Dhomave të Specializuara.

17 Sa i takon çështjes së USB-së, pra, çështja e ngritur, pika e  
18 ngritur në parashtrimet me shkrim është që materiali në video  
19 është thuhetse 60, 70 [sipas përkthimit] gigabajt që nuk mund të  
20 bëhet përmes DV [sipas përkthimit] por përmes USB-ve. Ju  
21 falënderoj për shpjegimet e dhëna.

22 Pra, do të doja të pyesja në qoftë se ndonjë gjë e tillë mund  
23 të realizohet deri të hënën, sepse unë do të takohem me z.  
24 Haradinaj atë kohë. Pra, në qoftë se do të bëhej ndonjë ndryshim  
25 në këtë drejtim të hënën ose të martën, besoj që do të na

1 lehtësonte shumë punën në vijimësi.

2 Sa i takon qasjes së klientit, takimit me klientët, siç e tha  
3 z. Rees, ndërkohë që ne e kuptojmë që duhet që të zbatojmë masat  
4 për sigurinë shëndetësore dhe të të gjithë personelit të stafit  
5 brenda Njesisë së Paraburgimit, fakti që vaksinat nuk do të  
6 përfundohen deri nga fundi i korrikut, i takon që do të ishte  
7 shumë e pamundur, ose me shumë pak gjasa për neve që të  
8 planifikojmë për procesin gjyqësor nga shtatori.

9 Kështu që për këtë arsye për neve është shumë e rëndësishme  
10 që të ulemi me klientët tanë, të diskutojmë me ta, dhe është e  
11 pamundur që ne të mund të punojmë në mënyrë efektive duke qenë të  
12 ndarë me një xham, apo duke kontaktuar në mënyrë -- në distancë  
13 pra, nëpërmjet telefonave.

14 Për shembull, në qoftë se do të kisha pasur mundësinë që të  
15 vija fizikisht në gjykatë në qoftë se situata do të ishte normale,  
16 unë do të kisha diskutuar me z. Haradinaj dhe nuk do të isha ndarë  
17 me anë të një xhami. Pra, ajo çfarë po kërkoj unë është që në  
18 qoftë se mua do të më lejohej që të kontaktoja në një mënyrë të  
19 caktuar me z. Haradinaj po të kisha qenë i pranishëm në gjykatë,  
20 pse s'më lejohet e njëjta gjë me klientin tim në një mjedis  
21 tjetër, pra, në mjediset e paraburgimit.

22 Pra, sa i takon çështjes së përkthimeve, me çfarë kuptoj kjo  
23 është pika tjetër në agjendë, kjo ka të ngjarë që të rrisë më  
24 shumë mungesën e mundësisë që procesi gjyqësor të fillojë deri nga  
25 shtatori.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 ZPS-ja nuk e di, a ka ndonjë çështje për të shtuar lidhur me  
3 këtë pikë?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.

6 Z. Roche, dëshiron që t'i përgjigjesh Mbrojtjes, në veçanti  
7 lidhur me pikën që ka të bëjë me kohën që lidhet me ndryshimet e  
8 mundshme dhe përdorimin e USB-ve dhe dallimeve të politikave që  
9 përdoren në gjykatë dhe në ambientet e paraburgimit?

10 Z. Roche, fjala për ju.

11 Z. ROCHE: [Përkthim] Sa i takon ndryshimit potencial të  
12 politikës së përdorimit të USB-ve, unë do të filloj diskutimet për  
13 të ditur në qoftë se mund të ofroj mundësinë që të kemi një  
14 përgjigje për z. Cadman të hënën. Dhe siç u mundova t'ia shpjegoj  
15 edhe më përpara, ku nuk është një vendim që është në duart e mia,  
16 megjithatë ne do të mundohemi të bëjmë çdo gjë të mundur që të  
17 japim një përgjigje për juve.

18 Sa i takon vizitave dhe kushteve që aplikohen për vizitat me  
19 klientët në ambientet e paraburgimit, pra, dhe sa i takon  
20 mundësisë për t'u takuar ballë për ballë në gjykatë, kjo është  
21 diçka që nuk është bërë në mënyrë shumë të rregullt edhe koha,  
22 sigurimi edhe, le të themi, aspektet e sigurisë janë shumë të  
23 ndryshme nga një seancë -- nga seancat normale.

24 Gjithsesi mund shikoj pak në më tepër detaje, le të themi, sa  
25 i takon kushteve që duhet përmbushen kur takohet klienti në

1 Njësinë e Paraburgimit. Kjo është një çështje e re për neve,  
2 megjithatë, siç e thashë edhe më përpara, është e rëndësishme që  
3 të marrim parasysh elementët e sigurisë shëndetësore.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Cadman.

6 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Sa për të sqaruar,  
7 pra, do të doja të thosha që kjo nuk është hera e parë që e ngremë  
8 këtë pikë. Është ngritur dhe herë të tjera kjo pikë, ku qëndrimi  
9 që realizohet në sallën e gjykatës të mund të jenë të njëjtat me -  
10 - sa i takon marrëdhënies me klientin. Kjo është një çështje të  
11 cilën unë në fakt e kam ngritur edhe në konferenca të mëparshme  
12 për ecurinë e çështjes.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

14 Z. Rees, keni për të shtuar ndonjë gjë?

15 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, faleminderit i  
16 nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Së pari, më lejoni të  
18 falënderoj Zyrën e Administratorit për të gjitha përpjekjet për të  
19 -- për t'ju përgjigjur dhe për të zgjidhur çështjet e ngritura nga  
20 Mbrojtja, qofshin ato çështje që kanë të bëjnë me informacionin e  
21 teknologjinë, apo çështje që kanë të bëjnë me ambientet e  
22 paraburgimit. Falënderoj Zyrën e Administratorit për të gjitha  
23 përpjekjet e bëra. Disa përmirësime në fakt u pranuan edhe  
24 Mbrojtja sot, kështu që besoj që puna është në drejtimin e duhur.

25 Do të doja të falënderoja gjithashtu edhe Mbrojtjen dhe Zyrën

1 e Administratorit për përmirësime të mëtejshme p.sh., që mund të  
2 lidhen me numrin e gigabajtëve që mund të përdoren në sistem, apo  
3 disponueshmërisë për mjetet e transferimit të informacionit apo të  
4 komunikimit. Kjo është një çështje të cilës ne do t'i drejtohemi  
5 sërish në konferencën e radhës në qoftë se gjërat nuk janë  
6 zgjidhur deri në fund, por gjithsesi për momentin më lejoni dhe  
7 njëherë të falënderoj palët për shqetësimet e ngritura.

8 Le të kalojmë tani te pika tjetër e agjendës për sot, që  
9 është marrëveshja për pikat e ligjit dhe të faktit.

10 E di që ZPS-ja ka komunikuar për Mbrojtjen 39 fakte të  
11 dakorduara të propozuara, ndërkohë që nuk është marrë një  
12 përgjigje nga ZPS-ja.

13 Konstatoj po ashtu që Mbrojtja e Gucatit ka vlerësuar se  
14 marrëveshja për pikat e faktit ka pak gjasa, me përjashtim të të  
15 dhënave të detajuara biografike, dhe datat e konferencave për  
16 shtyp dhe të folësve në të. Po ashtu jam në dijeni të Mbrojtjes së  
17 Haradinajt që ai -- që Mbrojtja synon që të konfirmojë fakte të  
18 cilat janë të afta për dakordësi, por vetëm në fund të procesit të  
19 nxjerrjes edhe vetëm pasi të jenë marrë udhëzimet nga i akuzuari  
20 për çështjen në fjalë.

21 Do të doja që palët tani të shtjellonin shanset për të  
22 identifikuar një listë të çështjeve që janë objekt i  
23 mosmarrëveshjeve dhe çështjeve të cilat nuk janë objekt i  
24 mosmarrëveshjeve.

25 Zoti prokuror, fjala për juve.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit Gjykatës.

2 Përpyjekjet tona të pasuksesshme për të siguruar fakte të  
3 dakordësuara reflektohen në parashtrimet me shkrim. Është e qartë  
4 të paktën nga Mbrojtja e z. Gucati që nuk do të kemi marrëveshje  
5 domethënëse.

6 Ndërkohë që ju përmendët tri kategori të informacionit ku --  
7 Mbrojtja e z. Gucati përmend, për të cilat ata mund të bien  
8 dakord. Ndërkohë që do të doja të thosha që këto pjesë e 39  
9 fakteve për të cilat neve jemi shprehur, pra, që janë dërguar për  
10 juve më 12 mars.

11 Po ashtu vëmë re që ju keni përcaktuar afatin 9 prill në  
12 mënyrë që të mund të biem dakord. Ne jemi të disponueshëm për të  
13 diskutuar pra, jemi për të diskutuar për çdolloj mendimi ose për  
14 çfarëdolloj gjëje që do të na kërkojë Mbrojtja.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.

16 Z. Rees, fjala për juve.

17 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Juve i nderuar  
18 Gjykatës patjetër thatë që kemi -- d.m.th., parashikuar afatin  
19 kohor për të filluar procesin, por nga ana tjetër thatë që nuk  
20 është një proces i detyrueshëm.

21 Siç e dini, i nderuar Gjykatës, ne kemi punuar fort për  
22 procesin e nxjerrjes së informacionit. Këto janë pika, çështje të  
23 cilat do të vazhdojnë që të shtjellohen prej nesh dhe të ngrihen  
24 sepse nuk janë ende të zgjidhura. Sigurisht që ne do të  
25 angazhohemi për sa i takon ngushtimit të pikave për atë kohë sa

1 është e mundur.

2 Por, lidhur me faktin që kjo çështje ka qenë përmendur në  
3 agjendë që për konferencën e dytë për gjendjen gjyqësore, është e  
4 vështirë për neve për t'u përfshirë -- të kuptimtë në këtë proces,  
5 dhe ne jemi në procesin ku po mundohemi që të ngushtojmë çështjet  
6 të cilat do të paraqiten si pjesë e dosjes paragjyqësore.

7 Sa i takon dokumenteve të parashtruara nga ZPS-ja, pra, ajo  
8 nuk i referohet asnjë pike të ligjit për marrëveshje. Ajo i  
9 referohet disa pikave të faktit. Por unë nuk e di në qoftë se ju i  
10 nderuar Gjykatës e keni parë këtë dokument apo jo, por nuk flitet  
11 për çështje të cilat do t'i çojnë shumë më përpara në mënyrë  
12 domethënëse, le të themi, procesin deri në këtë pikë. Për  
13 shembull, në paragrafin 13 të parashtrimeve tona të shkruara, ne  
14 kemi dhënë detaje sa i takon deri në çfarë pike mund të arrijmë  
15 marrëveshje.

16 Por ne do të japim, le të themi, parashtrimet tona, do të  
17 japim pozicion tonë kur të vijë koha. Edhe ne mendojmë që në  
18 momentin kur të ofrohet dosja paragjyqësore, besoj se do të jemi  
19 në një pozicion më të mirë për t'u futur në diskutime më  
20 thelbësore dhe më të qenësishme me ZPS-në lidhur me këtë pikë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

22 Z. Cadman, fjala për juve.

23 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit i  
24 nderuar Gjykatës.

25 Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar. Çdo gjë u tha nga z.



1 Rees, dhe ne e dimë rëndësinë e ngushtimit të çështjeve për  
2 Panelin e Gjykimit. Pra, ne do të përpiqemi që të japim vëmendjen  
3 tonë të plotë për këto pika.

4 Pra, sigurisht do të ketë çështje të cilat do të duan që t'ia  
5 ngremë ZPS-së sa i takon fakteve dhe çështjeve materiale, por ne  
6 nuk është e thënë që të trajtojmë apo të kundërshtojmë çdo pikë të  
7 mundshme, por do të jemi të arsyeshëm dhe ne do të përgjigjemi  
8 sipas nevojës edhe sipas interesit më të mirë të klientëve tanë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

10 Zoti prokuror, keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këtë  
11 çështje?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, asgjë tjetër i nderuar Gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë. Atëherë kjo çështje mbase  
14 do të përfundojë në momentin kur të parashtroni dosjen  
15 paragjyqësore në qershor. Nuk besoj se kjo çështje do të dalë më  
16 përpara konferencës tjetër të ecurisë së çështjes.

17 Tani le të kalojmë te pika tjetër në rendin e ditës për sot,  
18 pika e përkthimeve. Së pari do të doja që t'i referohesha  
19 drejtimeve të cilat parashikohen në paragrafët 62, 64 të vendimit  
20 kuadër për nxjerrjen e informacionit F104, sipas të cilit:

21 Pranohet se i akuzuari ka të drejtën sipas nenit 21(4)(a) të  
22 Ligjit që të informohet në një gjuhë ai e kupton për natyrën dhe  
23 shkakun ndryshimeve -- e akuzave të ngritura kundër tij, në rastin  
24 në fjalë pra, në gjuhën shqipe. Megjithatë, e drejta në vetvete  
25 nuk është e barabartë me një të drejtë absolute për të marrë të

1 gjitha provat, dokumentet dhe dosjet në gjuhën e të akuzuarit.  
2 Përkthimi i të gjithë dosjes gjyqësore, përfshirë këtu provat, do  
3 të cenonte të drejtën për proces të drejtë ligjor në kohën e  
4 arsyeshme. Kështu që do të duhet që të gjendet një baraspeshë  
5 ndërmjet këtyre dy të drejtave konkurrenente në mënyrë që procedurat  
6 të jenë të drejta dhe të shpejta.

7 Si rezultat, Rregullorja parashikon se të gjitha deklaratat e  
8 dëshmitarëve, të cilët ZPS-ja synon që të thërrasë për dëshmi në  
9 proces gjyqësor do të duhen të bëhen të disponueshme në një gjuhë  
10 që e flet dhe kupton i akuzuari. Ndërkohë që të gjitha provat e  
11 tjera duhet që të parashtrohen në gjuhën angleze në përputhje me  
12 vendimin për gjuhën e punës, me përjashtim të rasteve kur vendoset  
13 ndryshe nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

14 Ndihma pa pagesë e një interpreti së bashku me këshillat  
15 profesionale të Mbrojtjes e ndihmon të akuzuarin për të kuptuar  
16 provat dhe dokumentet e tjera të lidhura të cilat nuk janë në  
17 shqip. Mbrojtja mund t'i kërkojë ZPS-së që të ofrojë përkthimin në  
18 shqip të provave specifike, ose pjesëve të tyre, të ndryshme nga  
19 deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon që të thërrasë për  
20 të dhënë dëshmi në gjykatë.

21 Kur e bën një kërkesë të tillë, Mbrojtja duhet të thotë  
22 arsyet se pse është e domosdoshme që këto prova ose këto pjesë të  
23 provave duhet të merren në gjuhën shqipe, dhe pse i akuzuari nuk  
24 është në pozicion që të vlerësojë përmbajtjen e këtyre provave me  
25 ndihmën e një interpreti dhe këshillimi të Mbrojtjes.

1 Në rast të mospajtimit ndërmjet Mbrojtjes dhe ZPS-së në këtë  
2 aspekt, Mbrojtja duhet t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës  
3 Paraprake sa më shpejt të jetë e mundur.

4 Lidhur me mosmarrëveshjen në fjalë, unë konstatoj se në  
5 përputhje me ZPS-në, ZPS-ja ka përfunduar të gjitha përkthimet të  
6 cilat kërkohen me ligj për t'u përgatitur Mbrojtja.

7 Konstatoj nga parashtrimet e Administratorit që të gjitha  
8 dokumentet që kërkohen me ligj që të përkthehen do të përfundojnë  
9 së përkthyeri më datë 17 maj 2021, ku rishikimi i rregullës 86(3)  
10 do të përmbushet. Zyra e Administratorit thotë po ashtu që  
11 përkthimi i dosjes paragjyqësore të ZPS-së, përfshirë dëshmitarët,  
12 listat e provave, dhe rregullën 109(c) pra, tabelën e parashikuar  
13 në rregullën 109(c), do të dorëzohen nga ZPS-ja më datë 9 prill,  
14 dhe kjo planifikohet që të përfundojë më 15 qershor 2021, por  
15 marrja e kërkesave për përkthime të cilat janë me përparësi mund  
16 të ketë ndikim mbi këtë vlerësim.

17 Do të doja të thosha gjithashtu që Mbrojtja e Gucatit  
18 dëshiron të caktojë një afat kohor për kërkesat për përkthim. Dhe  
19 po ashtu, do të doja të thosha që Mbrojtja e Haradinajt është  
20 shprehur që është shumë e rëndësishme që të merren materialet e  
21 përkthyer dhe që janë të rëndësishme për përgatitjen e mbrojtjes.

22 Mbrojtja e Haradinajt mendon se në qoftë se do të respektohen  
23 afatet kohore siç ato janë parashikuar deri tani, kjo në vetvete  
24 do të cenonte dhe do të paragjykonte të drejtën e Haradinajt për  
25 të përgatitur mbrojtjen e tij.

1 Tani do të doja që të dëgjonin nga palët për këto çështje. Të  
2 përcaktojmë në qoftë se mund të gjejmë një zgjidhje të mirë për  
3 t'i lejuar Mbrojtjes që të përdorë përkthimet e ZPS-së përpara  
4 afateve kohore në mënyrë që ata të bëjnë përgatitjet e nevojshme  
5 për të dorëzuar më pas dosjen paragjyqësore. Edhe do të kërkoja në  
6 qoftë se mund të bëhen përkthime të caktuara, ose përkthime të  
7 pjesshme, dhe të vihen në dispozicion të palëve më -- përpara 15  
8 qershorit 2021.

9 E kuptoj që Zyra e Administratorit mbase mendon që po ushtroj  
10 goxha trysni, presion për këtë çështje, megjithatë do të doja që  
11 të dëgjonim Zyrën e Administratorit.

12 Z. Roche.

13 Z. ROCHE: [Përkthim] Po, faleminderit i nderuar z. Gjykatës.

14 Siç e thamë edhe më përpara, ne kemi dosjen F00192, kemi  
15 dhënë dhe afatet kohore sa i takon versionit të përkthyer, nuk dua  
16 ta përsëris atë çfarë është thënë më parë.

17 Atëherë, sa i takon, le të themi, dosjes paraprahe, përkthimi  
18 thuajse ka përfunduar. Ndërkohë jemi në procesin e rishikimit të  
19 përkthimit që është proces standard i punës së përkthimit.

20 Por në qoftë se, i nderuar Gjykatës, juve na kërkon që të  
21 japim si version paraprahe, le të themi, materialin e parishikuar,  
22 vetëm thjesht të përkthyer në dorën e parë, atëherë mund të themi  
23 që këtë informacion ose këtë dokument mund t'ua japim në  
24 dispozicion më datën 7 maj. Bëhet fjalë për një dokument prej 82  
25 [sipas përkthimit] faqeve. Pra, siç e thashë edhe më përpara pra,

1 materialet me shkrim të parishikuara por vetëm të përkthyer në  
2 dorën e parë, mund të jepen më datë 7 maj, ndërkohë që  
3 informacionet e -- dokumentet e rishikuara mund të jepen në një  
4 datë më të vonë.

5 Ndërkohë që sa i takon afatit kohor të përkthimit që është  
6 pjesë e dosjes paragjyqësore të Prokurorisë pra, afati kohor për  
7 materialin e përkthyer dhe të rishikuar do të qëndrojë sërish në  
8 atë çfarë kemi deklaruar më përpara pra, më datën 15 qershor.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Roche, faleminderit për  
10 propozimin konkret.

11 Tani më lejoni t'ia jap fjalën ZPS-së. Zoti prokuror, fjala  
12 për ju.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

14 Dëshëm në fakt të flasim pak për kuadrin e përkthimit dhe për  
15 dosjen paraprake.

16 Së pari, nuk është fare çështje që të kundërshtoj. ZPS-ja u  
17 detyrua ta parashtrojë dosjes paraprake në anglisht. Nuk ka ndonjë  
18 kërkesë ligjore për një -- përkthimin e kësaj dosjeje paraprake,  
19 as një parakusht që Mbrojtja të dorëzojë dosjes e saj paraprake.

20 Juve tani po përcaktoni kuadrin. Duke pasur parasysh  
21 parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit përpara kësaj konference duket  
22 më pak kategorike. Por ne deshëm të theksojmë se skema ligjore  
23 përcakton vetëm disa dokumente që kërkojnë përkthim.

24 Ju dhatë një listë të ngjashme. Ata duhet të jenë në gjendje  
25 të kuptojnë natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tyre, aktakuzën,

1 materialet mbi të cilat mbështetet aktakuza, deklaratat e  
2 dëshmitarëve të cilët ZPS-ja do t'i thërresë në gjyq, dhe më --  
3 pastaj aktvendimet e Gjykatës dhe të Dhomës së Apelit.

4 Por skema ligjore përcakton kategori diskrete të materialeve  
5 tek të cilat Mbrojtja -- Prokuroria do t'i përdorë. I gjithë  
6 informacioni deri tani që futet në këtë kategori është bërë, është  
7 nxjerrë, përkthimet janë dhënë apo do të jepen, dhe gjyqi nuk mund  
8 të vonohet për shkak të përkthimeve përtej kërkesave ligjore për  
9 këtë gjë.

10 Në rrethanat e kësaj çështjeje, dosja paraprake e Prokurorisë  
11 nuk shton shumë për sa i takon informacionit që i akuzuari nuk e  
12 ka tashmë në shqip. Një pjesë e madhe e provave të ZPS-së në këtë  
13 çështje përbëhen nga deklaratat të hapura të të akuzuarit të bëra  
14 në shqip dhe të përkthyer në anglisht.

15 I akuzuari nuk kërkon përkthim të argumenteve të ZPS-së në  
16 lidhje me fjalët e vetë të akuzuarve për të kuptuar rëndësinë e  
17 tyre. Ka një rregull të gjithëpërfshirshëm për përshkrimin 86(3)  
18 [sipas përkthimit] që ka shumë gjëra të përbashkëta me dosjen  
19 paraprake që do ta vëmë në dispozicion në shqip muajin që vjen,  
20 siç tha përfaqësuesi i Administratës.

21 Përveç kësaj, të gjithë deklaratat e dëshmitarëve që ne do  
22 t'i thërresim dhe versionet shqip të mbi -- janë gati mbi gjysmën  
23 e provave. A mund -- ne kemi parasysh atë që tha Zyra e  
24 Administratës lidhur me paraqitjen e përkthimeve jozyrtare që do  
25 ta përshpejtojë çështjen.

1 Edhe në vlerësim që thatë -- 15 qershorit, ky parashikim  
2 parashikon përkthimin e të gjithë shtojcave bashkë me dosjen  
3 paraprahe që përfshin 56 [sipas përkthimit] faqe dhe 72 faqe në  
4 bazë të rregullës 102 [sipas përkthimit]. Në qoftë se vetëm dosja  
5 paraprahe do të caktohej si përparësore edhe me një përkthim  
6 jozyrtar, kjo do të ishte e mundshme përpara 15 qershorit. Nuk ka  
7 asgjë në këto 72 faqe të tabelës që nuk gjendet në dosjen  
8 paraprahe. Ajo tabelë përmban citime që ka -- që të çojnë te  
9 dosja.

10 Mbrojtja e Haradinajt nuk mund të presë me arsye që gjyqi të  
11 presë derisa të përkthehet çdo dokument për kënaqësinë e tyre. Të  
12 akuzuarit kanë apo do të kenë së shpejti të gjithë përkthimet e  
13 nevojshme për t'u përgatitur për gjyq.

14 Dhe këtë doja të thosha lidhur me çështjen. Kemi dëgjuar për  
15 vonesat e mundshme në lidhje me këtë, me atë, dhe gjyqi nuk mund  
16 të fillojë përpara vjeshtës. Mbrojtja ka pasur gjithë këtë kohë  
17 për të marrë udhëzime dhe për të hetuar çështjen.

18 Është një çështje e vogël. Ka të bëjë me veprime dhe sjellje  
19 të të akuzuarit për një periudhë më pak se njëmuajore. Një pjesë e  
20 madhe e provave janë vetë deklarata publike të të akuzuarit, dhe  
21 nuk mund të thotë që si kupton. Mbrojtja sigurisht duhet të ketë  
22 mjetet e nevojshme, kohën e nevojshme për t'u përgatitur, por çdo  
23 vëzhgues i vëmendshëm po të na dëgjonte do të kuptonte që Mbrojtja  
24 ka kohën dhe mundësitë e duhura për t'u përgatitur.

25 T'i kthehem çështjes që -- pyetjes që bëtë përpara. Afatet

1 tuaja në kalendarin e konsoliduar janë të arsyeshme dhe vazhdojnë  
2 të jenë të tilla. Asgjë s'ka ndodhur për sa i takon përkthimit apo  
3 ndonjë gjë tjetër që do të justifikonte, do të arsyetonte  
4 ndryshimin e datës.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.

6 Tani Mbrojtja. Z. Rees, ju lutem.

7 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë jam dakord me  
8 ato që tha z. Cadman, në qoftë se mundemi.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, patjetër.

10 Z. Cadman, ju lutem.

11 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Siç e dini, nuk  
12 kam nevojë të flas për gjërat që janë parashtruar me hollësi. Ka  
13 një dallim të madh midis ZPS-së dhe neve si Mbrojtje për atë që  
14 kërkohet. Mbështetet -- mbështetjet vazhdimisht në kërkesat  
15 ligjore lidhur me ato që duhen të përkthehen.

16 Duhet parë nëse këto kërkesa përputhen me detyrimet lidhur me  
17 ato që keni thënë ju dhe ç'thonë traktatet ndërkombëtare.

18 Kjo është një Gjykatë e Republikës së Kosovës e nuk është një  
19 gjykatë ndërkombëtare, dhe duhet të respektojë Kushtetutën e  
20 Kosovës dhe traktatet ndërkombëtare që janë pjesë e saj.

21 Çështja shtrohet nëse ajo që na jepet pajtohet me të drejtën  
22 sipas nenit 6(3). Qëndrimi jonë është që jo, nuk përputhet.  
23 Argumentin nuk duhet ta bëjë ZPS-ja, ajo mund të mbajë shënim. Nuk  
24 e ka detyrë ZPS-ja të përkthejë dosjen paraprake. Por që z. Gucati  
25 dhe z. Haradinaj të kenë një gjykim të drejtë kërkohet më shumë



1 sesa dokumente mbështetëse që duhen përkthyer, ndryshe nuk mund të  
2 shkojmë në gjyq.

3 ZPS-ja thotë që nuk mund të presim me arsye -- që Gjykata të  
4 presë. Kurse ne themi, po, mund të presë, dhe duhet të presë që të  
5 sigurojë që këta dy persona, dy individë të kenë mundësi të  
6 përgatiten si duhet për një gjykatë -- për një gjykim lidhur me  
7 një çështje shumë serioze. Mbase s'është serioze, e rëndësishme  
8 për ZPS-në - se sapo tha prokurori që është një çështje e vogël -  
9 por të pandehurit kanë të drejtë të dinë natyrën, shkakun e  
10 akuzave të ngritura kundër tyre dhe materialin që do të paraqitet.

11 Parashtrimi ynë është që dosja paraprake është pjesë  
12 përbërëse e kësaj, dhe ne duhet të jemi në gjendje të marrim  
13 udhëzime të duhura nga të pandehurit me qëllim që edhe ne të  
14 parashtrojmë dosjes tonë si kundërpërgjigje.

15 Ju i keni parashtrimet tona me shkrim. Nuk po futem më në  
16 hollësi, po ka një dallim themelor në opinion midis asaj që  
17 kërkohet dhe midis asaj që është e arsyeshme për të siguruar një  
18 gjykim të drejtë. Pra, në qoftë se nuk bëhet si duhet, ka një  
19 rrezik të madh që të pandehurit nuk do të kenë një gjykim të  
20 drejtë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

22 A mund të më thoni nëse propozimi i Administratës d.m.th.,  
23 për t'i dhënë Mbrojtjes një version të parashikuar të materialeve  
24 të lidhura me dosjen paraprake deri më 7 maj, do të ishte me dobi  
25 për përgatitjen e gjyqit nga ana juaj, apo dëshironi që të merrni

1 vetëm versionin e rishikuar?

2 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

3 I jam shumë mirënjohës Zyrës së Administratës për këtë, dhe  
4 mbase duket sikur po ankohe shumë, kështu që ne jemi shumë  
5 mirënjohës për këtë që tha Zyra e Administratës, dhe me gatishmëri  
6 do ta pranoni, me dëshirë do ta pranoni përkthimin e  
7 parishikuar.

8 Sa më shumë shpejt ta kemi, aq më shpejt do të përgatitemi  
9 për gjyq.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Do t'i lutesha Zyrës së Administratës që t'ia kalonte, t'ia  
12 transmetonte versionin e parishikuar. Por në një fazë të mëvonshme  
13 kur versioni i rishikuar të jetë gati sepse -- edhe po i kthehem  
14 përkthyesve me gojë, sepse disa prej tyre me siguri janë dhe  
15 përkthyes me shkrim - të përfshijnë dhe korrigjimet, ndryshimet,  
16 me qëllim që të pandehurit të shohin qartë dhe shpejtë nëse ka --  
17 është bërë ndonjë korrigjim i cili është me rëndësi, apo ka një  
18 rëndësi të tillë që do të ishte me përfitim për Mbrojtjen në  
19 përgatitjen e saj. Faleminderit Mbrojtjes -- Zyrës së  
20 Administratës.

21 Ka ndonjë gjë tjetër që mund të thoni për përkthimet?

22 Zoti prokuror.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Siç mund ta imagjinoni, ne kemi  
24 shumë për të thënë lidhur me kuadrin ligjor i cili përputhet me  
25 Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe mënyra sesi është

1 zbatuar. Gjithashtu mund të theksojmë se rregullat janë  
2 kushtetuese, janë konstatuar si të tilla nga Gjykata Kushtetuese.

3 Megjithatë, duke pas parasysh se gjykata -- e Haradinajt u  
4 shpreh në lidhje me këtë, nuk po shprehemi më tej.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman, dëshironi të shtoni  
6 ndonjë gjë tjetër?

7 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit i  
8 nderuar. Jo, jo në këtë fazë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Roche, doni të shtoni diçka mbas shkëmbimeve midis palëve?

11 Z. ROCHE: [Përkthim] Jo, faleminderit. Ne e morëm shënim  
12 diskutimin e zhvilluar lidhur me përkthimin e dosjes paraprake. Do  
13 ta shqyrtojmë këtë çështje dhe do t'ju njoftojmë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. E vlerësojmë  
15 shumë.

16 E shoh që ka kaluar ora 12.30, prandaj do të bëjmë një pushim  
17 të shkurtër prej 20 minutash për përkthyesit, dhe do të kthehemi  
18 përsëri mbas 20 minutash për të diskutuar pikën e fundit të  
19 programit.

20 E bëjmë pushim tani.

21 --- Pauza fillon në orën 12.33

22 --- Rifillon në orën 12.52

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, tani do të kalojmë te pika  
24 e fundit në agjendë që lidhet me hetimet.

25 Konstatoj se ZPS-ja tregoi se do të vazhdojë hetimet sipas

1 nevojës, sidomos në dritën e çdo prove që zgjedhja -- që Mbrojtja  
2 mund të paraqesë, por ZPS-ja nuk parashikon ndonjë aktivitet  
3 hetimor që do të ndikojë në kalendarin e konsoliduar.

4 Konstatoj se hetimet e Mbrojtjes janë në vazhdim e sipër, dhe  
5 një ekip i Mbrojtjes synon të organizojë një mision tjetër hetimor  
6 në fund të majit.

7 Së pari, ftoj ZPS-në të japë një përditësim lidhur me hetimet  
8 e veta.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit i nderuar.

10 Në fakt nuk mund të shtojmë gjë tjetër këtu përveç asaj që ju  
11 përmblohdhët. Nëse keni pyetje të veçanta, mund t'ju përgjigjemi.  
12 Kaq kemi për këtë çast -- për këtë temë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti prokuror.

14 Tani ftoj Mbrojtjen të na flasë se ku është me hetimet e  
15 veta, duke përfshirë dhe provat që ajo -- vëllimin e provave që do  
16 t'i nxjerrë ZPS-së, dhe nëse parashikon të paraqesë kërkesa për  
17 masa mbrojtëse. Gjithashtu e ftoj Mbrojtjen të lidhet me Zyrën  
18 Administrative lidhur me çdo çështje logjistike që ka të bëjë me  
19 udhëtimin e tyre në Kosovë. Dhe së fundi, i drejtohem Mbrojtjes  
20 për të vënë në dukje nëse janë në rregull me afatet e mbetura të  
21 parashikuara në kalendarin e konsoliduar dhe materialet e vendimit  
22 në bazë të rregullit -- vendimin për materialet në bazë të  
23 rregullit 102(3).

24 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne, siç kemi thënë  
25 në konferencat e tjera, kemi vënë në dukje -- kemi bërë një

1 përshkrim të hetimeve tona. Neve kemi një afat kohor për t'i kryer  
2 këto hetime dhe për të respektuar afatet e kalendarit të  
3 konsoliduar.

4 Sikundër kemi thënë në përgjigjen me shkrim, aktualisht  
5 parashikojmë që t'u përmbahemi afateve të mbetura në kalendarin e  
6 konsoliduar për të respektuar afatin siç parashikohet, për të  
7 paraqitur dosjen paraprake dhe të jemi gati për gjyq, siç kemi  
8 thënë në parashtrimet me shkrim, në një moment pas fillimit të  
9 javës në fillim të gushtit [sipas përkthimit].

10 Sigurisht, kjo varet nga çështjet që po mblidhen gjatë kësaj  
11 konference. Mbasi të zgjidhen në mënyrë të suksesshme këto  
12 çështje, me çështjen e vazhdueshme të nxjerrjes së materialeve që  
13 po vazhdon, siç edhe ju e vutë në dukje, dhe sigurisht lidhet me  
14 zgjidhjen e aktakuzave të lidhura me apelin e ndërmjetëm dhe të  
15 gjithë hapat që do të ndërmerren më pas. Po në këtë fazë, siç kemi  
16 thënë në parashtrimet tona, besoj që do të jemi në gjendje t'u  
17 përmbahemi këtyre afateve.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

19 Z. Cadman, ju lutem.

20 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

21 Edhe ne kemi të njëjtin qëndrim sikurse dhe Mbrojtja e z.  
22 Haradinaj. Parashikojmë që mision -- të bëjmë një mision të  
23 përbashkët me ekipin tjetër në maj. Unë aktualisht ndodhem në  
24 Kosovë, dhe presim në fakt që të jemi në kohë, me kusht që të  
25 zgjidhen çështjet që ngriti z. Rees.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

2 Zoti prokuror, ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Jo.

3 Faleminderit shumë. Pra, tani dua t'u drejtohem palëve të  
4 shprehen për mendimin që kanë lidhur me konferencën e ardhshme për  
5 të trajtuar çështjet e mbetura përpara transmetimit të çështjes --  
6 dosjes së çështjes.

7 Mbrojtja e z. Gucati ka shprehur një parapëlqim për datën 28  
8 maj, të premtën. Nuk e di nëse kjo u përshtatet të tjerëve.

9 Zoti prokuror.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Ne jemi të disponueshëm sipas dëshirës  
11 suaj, dhe data që përmendët është në rregull për ne.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Rees, keni ndonjë gjë tjetër lidhur me datën e propozuar  
14 28 maj?

15 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam.  
16 Faleminderit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Cadman, keni ndonjë gjë?

19 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë jam i  
20 disponueshëm në atë datë, i nderuar Gjykatës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të merrni një urdhër që do  
22 të përfshijë edhe agjendën e konferencës tjetër për statusin e  
23 çështjes.

24 U ftoj -- i ftoj palët të bëjnë parashtime me shkrim nëse  
25 duan të ngrenë ndonjë çështje konkrete në konferencën tjetër për

1 statusin e çështjes.

2 Tani dua t'i pyes palët nëse kanë ndonjë çështje tjetër që  
3 duan ta ngrenë.

4 Zoti prokuror.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Asgjë të mëtejshme.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Rees, ju lutem.

8 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit, i  
9 nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

11 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë nuk kemi dhe  
12 ne. Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 Dhe së fundi, do të jap dy urdhra me gojë:

15 Së pari, nxjerr një urdhër me gojë për ERN 095162-095239  
16 [sipas përkthimit], që i është bërë e njohur Mbrojtjes më 19 mars  
17 2021 në bazë të urdhrit tim F195 [sipas përkthimit]. Duke pasur  
18 parasysh gabimet e identifikuar nga ZPS-ja në këtë dokument  
19 sikurse renditen në ERN 095162-095239, unë urdhëroj Mbrojtjen --  
20 ZPS-në të përgatisë një version të rishikuar të dokumentit ERN  
21 093492-093590, ku të korrigjojë gabimet në fjalë dhe çdo  
22 mospërputhje tjetër, dhe t'ia japë këtë version të rishikuar  
23 Mbrojtjes deri të premtën, 7 maj 2021.

24 Dhe këtu përfundon urdhri im i parë me gojë.

25 Së dyti, i jap një urdhër me gojë ZPS-së për versionin e

1   paredaktuar të materialit të nxjerrë provues, nëse ka. Duke marrë  
2   parasysh fazën e avancuar të procesit paraprak e urdhëroj -- për  
3   transmetimin e çështjes, e urdhëroj ZPS-në që deri të premtën, 18  
4   qershor 2021, -- çdo version të paredaktuar ta nxjerrë sipas  
5   rregullës 102(1)(b) dhe 102(3) të Rregullores në përputhje me  
6   paragrafin 80 të vendimit kuadër për nxjerrjen, që është F104.

7           Dhe këtu përfundon dhe seanca e sotme.

8           I falënderoj palët për praninë e tyre. Falënderoj Zyrën e  
9   Administratës për gjithë punën që kanë bërë dhe që do të vazhdojnë  
10   të bëjnë për të lehtësuar procesin në interesin e një gjyqi të  
11   drejtë dhe efikas.

12           Si zakonisht, falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët  
13   dhe personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

14           Sanca përfundon.

15                         --- Konferenca për ecurinë e çështjes përfundoi në  
16                         orën 13.00

17

18

19

20

21

22

23

24

25